



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 24.05.2023

Nr: 139

Ora: 16:00

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 78, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA “PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET ”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, përfaqësuar nga z. Klardi Xhemali

**OBJEKT:**

1. Kundërshtim i tabelës së rezultateve për QV nr. 3239 të GNV nr. 1, datë 16.05.2023, të KZAZ nr. 62, Mallakastër.
2. Rinumërim dhe rivlerësim i votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshill për QV 3239.
3. Ndryshimin e tabelës për rezultatin për këshillin bashkiak Mallakastër duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.



**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Partia “Drejtësi, Integrim dhe Unitetit” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 78 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 24.05.2023, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 78 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 78, datë 22.05.2023, të paraqitur nga “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 30.05.2023, ora 15:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>